



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



REC

RECONCILIATION EMPOWERING COMMUNITIES



Informata për nevojat e komunitetit

REC
Mitrovicë, janar 2022

Autor:
Reconciliation Empowering Communities (REC)



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ky publikim është prodhuar në kuadër të Aktivitetit për Bashkëpunim në Komunitet, financuar nga USAID, dhe është përgatitur nga REC - Reconciliation Empowering Communities.


Përmbajtja


Rreth REC-it.....	4
Hyrje.....	5
Profili i shkurtër i komunës së Mitrovicës së Jugut dhe fshatrave të synuara.....	6
Nevojat specifike të komuniteteve të identifikuar përmes takimeve të dialogut në komitet.....	6
Profili i shkurtër i komunës së Mitrovicës së Veriut dhe fshatrave të synuara.....	10
Nevojat specifike të komuniteteve të identifikuar përmes takimeve të dialogut në komitet.....	10
Profili i shkurtër i komunës Lepsaviqit dhe fshatrave të synuara.....	14
Nevojat specifike të komuniteteve të identifikuar përmes takimeve të dialogut në komitet.....	15
Gjetjet kryesore nga takimi me qytetarë.....	17
Profili i shkurtër i komunës së Skënderaj dhe fshatrave të synuara.....	17
Nevojat specifike të komuniteteve të identifikuar përmes takimeve të dialogut në komitet.....	17
Gjetjet kryesore nga takimi me qytetarë.....	18
Rekomandimet.....	19

Rreth REC-it

OJQ REC - Reconciliation Empowering Communities, është organizatë joqeveritare me seli në Mitrovicë. Puna e saj kryesore është promovimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë kosovare duke angazhuar potencialin njerëzor në mesin e komuniteteve të ndryshme. OJQ REC është e fokusuar në avokim dhe lobim, të drejtat e njeriut, demokratizim, sundim të ligjit dhe fuqizimin e komunitetit përmes qytetarisë aktive. Organizata joqeveritare "Reconciliation Empowering Communities" (REC) shtrihet me punën e saj në komunën e Mitrovicës dhe më gjerë.

Ekipi i organizatës ka më shumë se 15 vite përvojë në shoqërinë civile dhe në zbatimin e projekteve të ndryshme që kanë të bëjnë me të kaluarën dhe pajtimin.

 Misioni i OJQ-së REC është: "Fuqizimi i komunitetit përmes qytetarisë aktive"

 Vizioni i OJQ- së REC është: "Demokratizim dhe ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve për një të ardhme të qëndrueshme socio-ekonomike dhe multietnike"

OJQ REC është duke zbatuar projekte në rajonin e Mitrovicës (në shtatë (7) komuna), bazuar në komunitet pa dallim feje, race, gjinie apo kombësie dhe puna e saj është e fokusuar në tri programe:

1. QEVERISJE E MIRË - Nëpërmjet këtij programi synojmë të promovojmë qytetarinë aktive duke kërkuar përgjegjësi dhe llogaridhënie nga institucionet, transparencë dhe qeverisje të mirë, sundim të ligjit dhe respektim të të drejtave të njeriut.
2. EKO MJEDISI - Qëllimi i përgjithshëm i programit është të avokojë pranë institucioneve në nivel qendror dhe lokal për mbrojtjen e mjedisit, duke i adresuar nevojat dhe problemet e qytetarëve.
3. RINIA DHE VULLNETARIZMI - Qëllimi i përgjithshëm i programit është të punojë në fuqizimin e të rinjve dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre përmes punës vullnetare si një mundësi për zhvillimin e karrierës dhe avancimin e komunitetit.

Rritja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike përbën një element kyç për zhvillimin dhe demokratizimin e një vendi. Përfshirja e grave në të gjitha aspektet e jetës politike është e rëndësishme jo vetëm sepse gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë, por edhe sepse realizimi i pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike është çështje e gëzimit të plotë të të drejtave të njeriut, të drejtësisë sociale dhe kusht i domosdoshëm për funksionimin më të mirë të një shoqërie demokratike.

Në kuadër të projektit “Përfshirja e grave dhe të rinjve nga zonat rurale dhe urbane në pjesëmarrjen aktive në dialog dhe politikëbërje në nivel lokal”, REC synon të krijojë një partneritet me: pushtetet lokale të katër komunave të synuara, komunitetin, përfaqësuesit nga shoqëria civile dhe mediat në mënyrë që të sigurohet se pjesëmarrja publike zbatohet dhe promovohet mirë dhe të rinjtë dhe gratë nga të gjitha komunitetet janë të përfshirë në procesin e vendimmarrjes duke ngritur çështjet dhe brengat e tyre.

Ky raport informativ përmbledhës, pasqyron nevojat e qytetarëve të identifikuar gjatë procesit të realizimit të projektit “Përfshirja e grave dhe të rinjve nga zonat rurale dhe urbane në pjesëmarrjen aktive në dialog dhe politikëbërje në nivel lokal”, duke përfshirë takime me përfaqësuesit e lagjeve

dhe fshatrave të targetuara, përfshirë: dy komuna me shumicë serbe në veri të lumit Ibër, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, dhe dy komuna me shumicë shqiptare në jug të lumit Ibër, Mitrovicë e Jugut, Skënderaj të përfshira për shkak të lidhjeve historike, dhe në interes të integritit dhe ndjeshmërisë ndaj konfliktit. Konkretisht projekti zbatohet në këto zona: Mitrovica Veriore, fshati: Suhodoll i Epërm, Lagjia e boshnjakëve dhe Kodra e minatorëve, me komunitet të përzier. Mitrovica Jugore, lagjia Rome dhe fshati Suhodoll i Poshtëm, me komunitet të përzier. Leposaviq, fshatrat: Bisticë, Cerajë dhe Koshtovë e Vllahisë, me komunitet shqiptarë si dhe komuna e Skënderajit.

Metodologjia

Ky raport është përgatitur duke kombinuar dy burime kryesore të informacionit:

- Të dhëna dytësore për situatën e përgjithshme në Leposaviq, Mitrovicën e Veriut, Mitrovicën e Jugut dhe Skënderaj, duke analizuar situatën politike, efikasitetin e institucioneve në trajtimin e pjesëmarrjes publike dhe nevojat specifike të komunitetit në komunat e synuara.
- Të dhënat primare nga takimet e drejtpërdrejta të dialogut me përfaqësuesit e kuvendeve, drejtuesit dhe gjithashtu komunitetin, duke përfshirë përfaqësuesit e fshatit/lagjeve, për të vlerësuar nevojat specifike të komuniteteve, duke përfshirë gratë dhe të rinjtë.

Profili i shkurtër i komunës së Mitrovicës së Jugut dhe fshatrave të synuara

Komuna e Mitrovicës së Jugut përfshin qytetin jugor të Mitrovicës dhe rreth 40 fshatra. Sipas regjistrimit të popullsisë dhe banesave në Kosovë të vitit 2011, popullsia e përgjithshme është 71,909.¹

Komuna e Mitrovicës së Jugut kryesisht aplikon tre mënyra për ofrimin e shërbimeve publike-administrative për qytetarët: 1) në zyrën përkatëse të shërbimit brenda komunës, ku qytetarët rreshtohen me numra elektronikë për të marrë lloje të caktuara të certifikatave të gjendjes civile; 2) përmes tre aparateve (makina) elektronike një të instaluar në hyrje të komunës, dhe dy në pjesë të tjera të qytetit dhe 3) përmes gjashtë zyrave të gjendjes civile të vendosura në gjashtë zona në territorin e komunës. Zyra e pritjes në hyrje të komunës është një tjetër pikë për ofrimin e shërbimeve dhe kjo ka lehtësuar shumë komunikimin ndërmjet drejtorive komunale, dhe komunës dhe qytetarëve. Megjithatë, përveç digjitalizimit të materialit gjeodezik dhe lëshimit të faturave të tatimit në pronë që mund të bëhen online (proces i mundësuar nga Ministria e Financave), nuk ka projekte të tjera që të mundësojnë ofrimin e shërbimeve publike-administrative online për qytetarët.²

¹OSBE, Raport mbi profilin e Komunës, Mitrovica veriore, 2018

²GAP Instituti, Ofrimi i Shërbimeve Administrative Publike në Nivel Lokal, 2018, https://www.institutigap.org/documents/77450_sherbimetpublikeadministrative-en.pdf

Pavarësisht këtyre elementeve pozitive dhe shmangies së radhëve të gjata në marrjen e shërbimeve, ende nuk është plotësisht e qartë se çfarë shërbimesh publike-administrative u ofrohen qytetarëve, cila është procedura e marrjes së tyre dhe cili është çmimi për çdo shërbim. Kutia e ankesave është i vetmi instrument për të paraqitur një ankesë për një shërbim, por nuk ka asnjë mekanizëm tjetër të besueshëm që i lejon qytetarët të japin mendime dhe sugjerime (jo vetëm ankesa) se si të përmirësohen më tej shërbimet publike-administrative.

Nevojat specifike të komuniteteve të identifikuara përmes takimeve të dialogut në komunitet:

Komuna ka themeluar gjashtë zyra të regjistrimit në gjashtë fshatra: Suhodoll i Epërm, Zhabar, Shupkovc, Tunell i Parë, Stantërg dhe Bare. Megjithatë, banorët e komunës së Mitrovicës vlerësojnë se kjo shtrirje territoriale nuk është e mjaftueshme për shkak se ka një distancë të konsiderueshme në mes të fshatit Zasellë dhe Kçiq dhe zyrës më të afërt të gjendjes civile në fshatin Shupkovc. Gjithashtu, përveç animit në hyrje të komunës në katin e parë në zyrën e pritjes, dhe në aneksin e komunës ku lëshohen certifikatat tjera, lëvizshmëria e personave me aftësi të kufizuara në katet e tjera komunale është e kufizuar.

Nga takimet e dialogut me komunitetet e targetuara dhe anëtarët e Kuvendit Komunal nga grupet e grave kuvendare, si znj. Flutura Kamberi (LDK) dhe znj. Valbone Sadiku (PDK) kanë diskutuar temat e të drejtave të komunitetit, nevojave dhe shqetësimeve të adresuara në komunë.

Pjesëmarrësit gjatë diskutimit adresuan shumë kërkesa karshi anëtarëve të Kuvendit Komunal, ndër to ishin kërkesa urgjente që duhet të adresohen, specifikisht:

Rregullimi dhe funksionalizimi i ashensorit në ndërtesën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, ku në atë ndërtesë gjenden edhe shumë organizata joqeveritare dhe ka shumë aktivitete kulturore dhe joformale për të rinjë. E nga mosfunksionimi i ashensorit, privohen nga këto aktivitete personat me aftësi të kufizuara;

- Pjesëmarrësit u dakorduan që të dorëzohet një kërkesë tek Zyra e Kryetarit për rregullim të ashensorit, si dhe anëtarët e Kuvendit Komunal të avokojnë që kjo të jetë pjesë e diskutimit në kuvend.
- Funksionalizimi i shtëpive të shëndetit në disa zona rurale ku ka objekte por nuk ka doktorë specialistë;

- Inicimi i takimeve me qytetarë të mbahet në disa zona rurale me anëtarë të Kuvendit Komunal.

Sa i përket gjendjes së përgjithshme që pasqyron përfaqësimin e qytetarëve në vendimmarrje, të gjeturat kryesore janë si vijojnë:

Qeverisja e mirë komunale. Sa i përket dëgjimeve buxhetore, takimet janë paralajmëruar vetëm për një kohë të shkurtër dhe nuk janë aspak transparente. Megjithëse ato publikohen në ueb-faqen e komunës, ato shpërndahen vetëm një ditë më herët në faqen e komunës në Facebook.



Mungesa e bashkëpunimit të komunës me grupet e interesit është e evidente. Ky bashkëpunim do t'ua kishin mundësuar që ta bënin planifikimin më të mirë të buxhetit vjetor dhe jo vetëm. Takimet me kryetarin janë të rralla dhe zakonisht ndodhin në dy dëgjime publike të përcaktuara sipas ligjit, pra nuk ka takime të oragnizuara ad-hoc në bazë të nevojave specifike. Poashtu vizitat në lagje mungojnë dhe shpesh realizohen vetëm për qëllime elektorale. Pjesëmarrësit kanë pasur ankesat se edhe konkurset e punës lajmërohen vonë, atëherë kur personat e kanë shumë të vështirë të aplikojnë.

Legjisllacioni aktual: Pjesëmarrësit ishin në dijeni të disa pikave mbi të cilat bazohet transparenca dhe llogaridhënia, si lajmërimi dy javë para mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, qasja në dokumente publike, etj. por kishte edhe aspekte për të cilat nuk ishin në dijeni pjesëmarrësit, si për shembull punonjësit për informim duhet të kthejnë përgjigje në kohën e duhur .

Pjesëmarrja e qytetarëve: Përgjithësisht u vlerësua nga komuniteti por dhe anëtarët e Kuvendit Komunal se përfshirja dhe angazhimi qytetar nuk është i kënaqshëm. Mungon iniciativa e qytetarëve në vendim-marrje lokale si dhe në aktivitete të organizuara qoftë nga komuna apo nga akterët e tjerë, e që për qëllim kanë rritjen e llogaridhënies dhe transparencës komunale. Kjo për shkak të besimit se qytetarët mund të mos luajnë ndonjë rol në vendimmarrje për çështje të caktuara.

Përfshirja e grupeve të marginalizuara:

Pjesë e takimeve ishin edhe persona të grupeve më të cenueshme – personat me aftësi të kufizuara. Përfaqësimi i tyre në nivel lokal është shumë i dobët. Mungesa e zbatimit të ligjit në procesin e punësimit të tyre, përkatësisht kuotat që ekzistojnë për punësimin e tyre nuk respektohen.

Administrata dhe reformat e saj: Janë bërë një varg reformash, por që prapë mbetet me mjaft sfida. U theksua se në komunën e Mitrovicës janë rreth 23 të punësuar për të lëshuar çertifikata, por efikasiteti i tyre nuk është aq i lartë. Makinat automatike për lëshimin e dokumenteve nuk janë në funksion, e që do të lehtësonte punën shumë sidomos përgjatë periudhës së verës atëherë kur kërkesat janë shumë të mëdha. Sa i përket komuniteteve pakicë, një gjë pozitive u përmend lirimi prej pagesave, vlera e të cilave është nën pesë (5) euro. Si aspekt pozitiv i administratës u përmend procesi i digjitalizimit të saj përmes platformës E- Kosova.


Gjatë takimit të dialogut publik me gratë dhe të rinjtë të mbajtur me anëtarët e Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut, 5 të rinjë dhe të reja nga zonat rurale dhe urbane për herë të parë kishin rastin të takonin dhe njoftonin anëtarët e kuvendit rreth problemeve të komunitetit të tyre.


Anëtarët e Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut, u zotuan se do të llobojnë dhe avokojnë në kuvend dhe drejtoritë përkatëse, që të ndikojnë në rregullimin dhe funksionalizimin e ashensorit në ndërtesën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe do të përpiqen se si grup i grave deputet në kuvend së bashku me organizatat e shoqërisë civile të mbajnë takime në komunitet në zonat rurale.


Në punëtorinë për avokim dhe mobilizim, rreth dhjetë (10) pjesëmarrës nga zonat rurale ishin për herë të parë në një trajnim të tillë.


Pos tjerash grupi multietnik me ndihmën e përkthyesit kanë diskutuar rreth problemeve që ata i afektojnë në jetën e përditshme në zonat e banuara me komunitete të ndryshme, si dhe mundësinë e mobilizimit në grupe joformale për të avokuar në institucione lokale për zgjedhjen e atyre problemeve.


Gjetjet kryesore nga takimi me qytetarë


 Takimi me asambleistët e Kuvendit Komunal dhe komunitetet kanë ngritur çështje dhe nevoja të komunitetit që duhet të përmirësohen përmes kanaleve dhe politikave komunale me sa vijon.³


 Zbatimi i planit për barazi gjinore është i domosdoshëm, duke përfshirë mbështetjen e viktimave të dhunës dhe strehimin e tyre.


 Bashkëpunimi ndërkomunitar është i vogël dhe duhet intensifikuar, me fokus tek gratë dhe të rinjtë.⁴

 Mungesa e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, përfshirë mungesën e pajisjeve radiologjike, si dhe funksionalizimin e mamografisë.

 Problemi i braktisjes së shkollës, sidomos i vajzave të reja për shkak të mungesës së transportit nëpër fshatra.

 Vonesa dhe transparenca në ndarjen e bursave studentore, për herë të parë është bërë kompletimi-ndërrimi i bursistëve, përshkak të ankesave të shumta për procesin e vlerësimit. Megjithatë, ne e kemi ngritur çështjen e mospagesës së rregullt dhe me kohë të bursave studentore.⁵

 Vizitat tek grupet e grave që janë të marginalizuara dhe nuk kanë qasje, duke përfshirë zonat rurale, duhet të intensifikohen.

 Plan konkret për fuqizimin e grave dhe vajzave, duke i përfshirë në këshillat e lagjeve dhe përfaqësuese të fshatrave, duhet të hartohet.

³ Takim i dialogut publik me përfaqësues të partive politike, aktivistë dhe qytetarë nga Mitrovica, 17 korrik 2021, Mitrovica e Jugut

⁴ Flutura Beka, deputete e LDK-së në Mitrovicë, 17 korrik 2021, Mitrovica e Jugut

⁵ Valbone Sadiku, deputete e PDK-së në Mitrovicë, 17 korrik 2021, Mitrovica e Jugut

Profili i shkurtër i komunës së Mitrovicës së Veriut dhe fshatrave të synuara

Komuna e Mitrovicës së Veriut, ka nevoja dhe problematika specifike që lidhen jo vetëm me funksionimin institucional por edhe atë ligjor, duke operuar ende nën dy sisteme shtetërore, atë serb dhe Kosovar. Edhe pse statuti komunal parasheh themelimin e gjashtëmbëdhjetë (16) drejtorive komunale, një gjë tillë mbetet ende e pazbatuar. Departamentet aktive janë: administrata e përgjithshme; financat, buxhetin dhe zhvillimin ekonomik; shërbimet publike, infrastruktura, inspektimet dhe situatat emergjente; urbanizmi, kadastra dhe gjeodezia; arsimi, kultura, rinia dhe sporti; mirëqenia sociale dhe shëndeti; dhe çështjet civile lokale dhe marrëdhëniet me publikun.

Në Mitrovicën e Veriut, ekziston një (1) qendër mjekësore klinike e drejtuar nga Serbia dhe një (1) shtëpi shëndetësore. Qendra shërben si institucioni kryesor shëndetësor për serbët e Kosovës nga mbarë Kosova. Në kompleksin universitar ekziston edhe një poliklinikë që ofron shërbime shëndetësore për studentët. Për më tepër, një institucion tjetër shëndetësor i drejtuar nga Serbia gjendet në lagjen etnikisht të përzier Suhodoll/ Suvi Do (burimi: spitali në Mitrovicën Veriut dhe poliklinika e studentëve).

Të gjitha komunitetet kanë qasje në kujdesin shëndetësor, ndërsa shqiptarët e Kosovës kryesisht i shfrytëzojnë shërbimet e ofruara nga spitali i vendosur në Mitrovicën Jugore. Shqiptarët e lagjes me komunitet të përzier Kodra e Minatorëve/Mikronaselje kanë qasje në qendrën shëndetësore që ndodhet në lagjen e tyre, e cila zyrtarisht i përket sistemit shëndetësor të Mitrovicës Jugore. Janë shtatë (7) shkolla fillore, gjashtë (6) shkolla të mesme, një (1) çerdhe me objekt parashkollor dhe një (1) shkollë e specializuar, e cila ofron arsim fillor dhe të mesëm për fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta.⁶

Nevojat specifike të komuniteteve të identifikuara përmes takimeve të dialogut në komunitet:

Nëpërmjet takimeve me qytetarët, OJQ REC ka synuar të kontribuojë në rritjen e përfshirjes së qytetarëve në identifikimin dhe adresimin e sfidave të komunitetit lokal të grupeve të nënpërfaqësuar, përmirësimin e bashkëpunimit multi-etnik për çështjet e komunitetit dhe bashkëpunimin e institucioneve dhe qytetarëve. Lidhur me këtë OJQ REC kanë ftuar përfaqësues të ndryshëm të partive politike që garojnë për

Mitrovicën e Veriut si dhe aktivistë të shoqërisë civile, media dhe qytetarë që të marrin pjesë në takimin e dialogut publik. Në Mitrovicën e Veriut dy sisteme funksionojnë paralelisht dhe qytetarët shpesh janë të hutuar se në cilin sistem të qasen. Moszbatimi i plotë i Marrëveshjes së Brukselit për sa i përket integritimit të administratës dhe departamentit komunal, gjithashtu puna e përgjithshme e komunës nuk është mjaft transparente dhe shpeshherë nuk ka mundësi që qytetarët të angazhohen në proceset vendimmarrëse.

Në takimin e dialogut publik me qytetarë dhe zyrtarë komunal, OJQ REC ka pasur të ftuar në panel znj. Aida Doli dhe z. Skender Sadiku, kandidatë për asambleistë të kuvendit komunal në Mitrovicën e veriut nga radhët e Iniciativës Qytetare "Mitrovica",

znj. Ljiljana Drazević, Aktiviste si dhe z. Vladimir Simić, Zyrtar për rini nga Komuna e Mitrovicës së Veriut, ku kanë diskutuar temat e të drejtave të komunitetit, nevojave dhe shqetësimeve të adresuara në komunën e Mitrovicës së veriut.

Pjesëmarrësit gjatë diskutimit adresuan shumë kërkesa karshi panelistëve si:

- Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe rregullimi i parqeve të vogla afër lagjeve të ndryshme;
- Të ushtrohet presion mbi autoritetet komunale për gjetjen e një zgjidhje më të qëndrueshme për qenët endacak të rrugëve, që përbëjnë rrezik për kalimtarët e rastit;
- Funkcionalizimi i ndriqimit publik në disa pjesë në veri të qytetit, si lagjia e doktorëve dhe Kodra e Minatorëve.



- Funksionalizimi i ambullantave në lagjet më të thella, si Kroj i Vitakut, Kodra e Minatorëve dhe Lagjia e Boshnjakëve;
- Inicimi i takimeve me anëtarë të Kuvendit Komunal, pas zgjedhjeve lokale të 17 tetorit 2021.

Për temat e ngritura është premtuar nga të pranishmit se në mandatin e ardhshëm në Kuvendin Komunal do të adresohen shqetësimet e ngritura nga ky takim dhe se do të ketë bashkëpunim në takimet e radhës.

Poashtu, në takimet e dialogut publik, janë identifikuar çështje që përcaktojnë gjendjen e përgjithshme të shërbimeve dhe raportin qytetarë-komunë, të paraqitura më poshtë në raport:

Për shkak të mungesës së integritimit të administratës komunale, qytetarët e Mitrovicës së Veriut ende përballen me vështirësi në sigurimin e dokumenteve të caktuara. Për shembull, ka problem me punën e kadastrit dhe lëshimin e dokumenteve. Meqenëse administrata komunale ka kaluar përmes integritimit në vitin 2013, puna aktuale e departamentit të Kadastrit është ende në gjendje jo funksionale. Shpesh kërkesat për dokumente paraqiten por duhen më shumë se disa muaj për të marrë dokumentet. Në anën tjetër, lëshimi i disa dokumenteve është në kuadër të komunës së Mitrovicës Jugore, e cila kërkon kohë të dyfishtë për lëshimin e dokumenteve të caktuara. Edhe pse shumë qytetarë, aktivistë dhe media u përpoqën të gjenin arsyen që dy komuna të bashkëpunojnë deri më tani nuk ka pasur rezultat.

Në seancat dëgjimore për buxhetin të organizuara nga komuna, ishte përshtypja e përgjithshme se nuk ka pasur promovim të mirë. Pjesëmarrësit patën përshtypjen se për shkak të kohës së shkurtër të shpalljes e cila bëhet vetëm në faqen e komunës në Facebook, pasi që ueb faqja zyrtare e komunës së Mitrovicës së veriut është jofunksionale, njerëzit nuk kanë mundësi të dëgjojnë dhe të marrin pjesë. Gjithashtu, nuk ka mundësi të takohen me kryetarin e komunës dhe të diskutohet me zyrtarët komunal për propozime të ndryshme që do t'i ndihmojnë lagjeve për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Legjislacioni aktual: Pjesëmarrësit në takimin e dialogut publik nuk ishin mjaftueshëm të informuar për legjislacionin aktual dhe për reformat e administratës publike në Kosovë. Pjesëmarrësit janë ankuar se për shkak të ekzistimit të dy sistemeve, nuk janë gjithmonë të njohur se në cilin sistem duhet të aplikojnë për dokumentet dhe stafin tjetër të nevojshëm. Administrata komunale duhet të rrisë përpjekjet e saj për t'ua shpjeguar qytetarëve kornizën ligjore të Kosovës në mënyrë që të maksimizojë përpjekjet e bashkëpunimit.

U diskutua dhe u pajtua me pjesëmarrësit se në Mitrovicën e Veriut mungon zbatimi i praktikave të qeverisjes së mirë. Shpesh fluksi i informacionit është në një nivel të ulët pasi informacioni shpesh vjen me vonesë ose nuk vjen fare.

Pjesëmarrja qytetare: Në përgjithësi është vlerësuar nga pjesëmarrësit e takimit të dialogut publik, se përfshirja dhe angazhimi qytetar nuk është i kënaqshëm. Disa nga pjesëmarrësit kanë deklaruar se me mbështetjen e UN Habitat-it të shtatë komunat në rajonin e Mitrovicës kanë miratuar Planet për Pjesëmarrjen e Qytetarëve, por askush nuk kishte informacion se çfarë përmban ky dokument. Komuna duhet të organizojë prezantim publik të dokumentit dhe t'u shpjegojë qytetarëve nevojën aktuale dhe ndryshimin që do të ndodhë.




Mungon iniciativa qytetare në vendimmarrjen lokale si dhe në aktivitete të organizuara qoftë nga komuna apo nga akterë të tjerë, të cilët synojnë rritjen e llogaridhënies dhe transparencës komunale. Kjo për shkak të humbjes së besimit të qytetarëve në mundësitë në vendimmarrje apo ndikim në ndryshimin apo përmirësimin e çështjeve të caktuara. Gjithashtu u diskutua se vetëm OJQ-të që mbështesin pushtetin vendor janë ato organizata që mbështeten nga Komuna e Mitrovicës së Veriut.

Administrata dhe digjitalizimi: Pjesëmarrësit diskutuan për rëndësinë e digjitalizimit pasi pandemia Covid-19 shpërfaqti të gjitha problemet në administratën publike. Pjesëmarrësit diskutuan se si nuk ishin në gjendje të merrnin dokumente apo informacione dhe se komunat nuk komunikojnë shumë mirë. Problemin më të madh siç e shohin ata në mos përpjekjen për tejkalimin e pasojave të pandemisë Covid-19 dhe për shkak të mungesës së materialit të ndryshëm disa nga qytetarët nuk kanë mundur të marrin të gjitha dokumentet.

Gjithashtu u përmend se makinat automatike për lëshimin e dokumenteve dhe certifikatave të caktuara shpesh nuk janë në dispozicion dhe nuk funksionojnë. Gjithashtu, u përmend se udhëzimet ishin bërë keq dhe se shpesh nuk ka asistencë.

Gjetjet kryesore nga takimi me qytetarë

Në Komunën e Mitrovicës së Veriut janë realizuar disa projekte si përshebull: ura e re që lidh Mitrovicën Veriut me rrugën rajonale Mitrovicë – Prishtinë, mbështetja e shkollave dhe spitaleve gjatë pandemisë Covid-19.

-  Zgjidhja e kërkesave individuale të qytetarëve dhe nevojave të tjera të adresuara nga palët në Komunën e Mitrovicës së Veriut, shpesh duhet të adresohen dhe të shkojnë në Mitrovicën e Jugut apo edhe në Prishtinë,⁷ për shkak të mos integritit të plotë të të gjitha departamenteve komunale.
-  Lagjja e Boshnjakëve ballafaqohet me shumë probleme si: Siguria, ndriqimi publik, mungesa e qendrës së mjekësisë familjare, dhe të tjera.
-  Përfaqësuesi nga Iniciativa Qytetare "Mitrovica", gjithashtu diskutoi se si nisma e tyre dëshironte të përfshinte të gjitha komunitetet që jetojnë në Mitrovicën e Veriut, por për shkak të presionit jo të gjitha komunitetet janë të përfaqësuara në atë listë, e cila për here të parë garon në zgjedhjet komunale.⁸

⁷ Vladimir Simić, Përfaqësues i Listës Serbe, 17 shtator 2021, Mitrovica e Veriut

⁸ Skender Sadiku, Përfaqësues i Iniciativës Mitrovica, 17 shtator 2021, Mitrovica e Veriut

Është theksuar nga pjesëmarrësit e takimit se bashkëpunimi në mes të komuniteteve është duke u përmirësuar, mirëpo, si pengesë më e madhe është presioni ndaj qytetarëve nga politikanët lokal pasi ata treguan një realitet tjetër që paraqitet nga politikanët.⁹

Ka shumë aktivitete jopolitike ku të dy komunat mund të bashkëpunojnë së bashku dhe të shmangin politikën e lartë në marrëdhëniet e tyre, por nuk ka vullnet për këtë.¹⁰

Papunësia dhe mbrojtja e ambientit nuk njohin kufijtë e fesë, komunitetit apo diçka tjetër.

Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet mbrojtjes së ambientit me theks të veçantë në Lagjen e Boshnjakëve si një nga zonat më të mëdha multietnike në Kosovë dhe që për shkak të mbeturinave dhe ndotjes, të rinjtë nuk ndihen të sigurt për të qenë jashtë.

Pika tjetër ku ata ranë dakord ishte që lagjet duhet të kenë qendra të vogla të mjekësisë familjare, pasi veçanërisht gjatë pandemisë Covid-19, qytetarët kishin nevojë për më shumë mbështetje dhe gjithashtu se informacioni është ndarë në baza ditore. Gjithashtu theksoi se qytetarët duhet të dinë qartë se kur dhe ku të shkojnë kur kanë ndonjë problem.

Çështja për të cilën është rënë dakord është që të gjitha lagjet duhen të kenë ndriçim publik në mënyrë që këto hapësira të jenë të sigurta për të gjithë qytetarët. Siç u theksua vetëm rrugët kryesore kanë ndriçim publik dhe veçanërisht shumë zona të largëta nuk kanë ndriçim.

Pikat e dakorduara janë kryesisht në dobi të qytetarëve dhe që nuk kanë asnjë prapavijë politike. Në fund anëtarët e partive politike janë pajtuar se do të vazhdojnë të kontribuojnë në mirëqenien e Mitrovicës pavarësisht nga komuniteti.¹¹

Profili i shkurtër i komunës Leposaviqit dhe fshatrave të synuara

Edhe Komuna e Leposaviqit, njësoj si Mitrovica veriore operon ende nën dy sisteme qeverisëse. Institucionet ende nuk kane bërë integrimin e plotë nën systemin qeverisës të Republikës së Kosovës, prandaj për qytetarët kjo është një problematikë dukshëm më e madhe ngase kërkesat për shërbime nuk kanë kanal in e duhur të adresimit.

Megjithatë, nga strukturat institucionale aktive, shërbimet kryhen në varësi të kushteve ekzistuese të elaboruara më poshtë. Sistemi i kujdesit shëndetësor parësor përfshin: një (1) shtëpi shëndetësore dhe tetë (8) njësi shëndetësore.

⁹ Ljiljana Drazević, Aktiviste e shoqërisë civile, 17 shtator 2021, Mitrovica e Veriut

¹⁰ Aida Doli, Përfaqësuese e Iniciativës Mitrovica, 17 shtator 2021, Mitrovica e Veriut

¹¹ Takim i dialogut publik me përfaqësues të partive politike, aktivistë dhe qytetarë, 17 shtator 2021, Mitrovica e Veriut

Sistemi i kujdesit shëndetësor parësor përfshin: një (1) shtëpi shëndetësore dhe tetë (8) njësi shëndetësore. Sektori i shëndetësisë ka 163 punonjës, 100 femra dhe 63 meshkuj, duke përfshirë mjekë, infermierë dhe personel ndihmës. Ekziston edhe një (1) njësi shëndetësore në fshatin shqiptar të Kosovës Bistricë/Bistrica me tre (3) personel mjekësor.

Janë katër (4) shkolla fillore, duke përfshirë një në fshatin Shqiptar, Bistricë, me 1,318 nxënës dhe 171 mësimitdhënës; dy (2) shkolla të mesme me 385 nxënës dhe 85 mësimitdhënës; dhe dy (2) kopshte. Komuna ka edhe tre fakultete - pedagogji, sport dhe agronomi si dhe një (1) kolegji - ekonomik. Këto fakultete janë pjesë e universitetit publik në Mitrovicën e Veriut.¹²

Nevojat specifike të komuniteteve të identifikuarra përmes takimeve të dialogut në komunitet:

Banorët e fshatit Bistricë, Cerajë dhe Koshtovë e Vllahisë janë ndër qytetarët më të lënë pas dore nga institucionet, ngase jetojnë në një komunë me shumicë serbe, të pa integruar plotësisht nën systemin e Republikës së Kosovës, dhe Zyrja civile në këtë komunitet është jo aktive. Këta qytetarë kalojnë ditë përballë sfidave të mëdha dhe thuajse të pakapërcyeshme.

Banorët e fshatrave të lartpërmendur janë shprehur të pakënaqur për investimin dhe kujdesin që u është bërë deri më tani, qoftë nga institucionet lokale apo qendrore. Asfaltimi i rrugës, sigurimi i transportit publik, sigurimi i karburantit për transportin e nxënësve nga tre fshatrat që vijojnë



¹² OSBE, Raport mbi profilin e Komunës, Leposaviq, 2018 https://www.ecoi.net/en/file/local/1014970/3256_1366724140_2013-01-kos-leposavi-u.pdf

shkollën fillore në fshatin Bistricë, më pas sigurimi i transportit për nxënësit që vijojnë mësimet në shkolla të mesme dhe në Universitetin e Mitrovicës, mungesa e përfaqësimit të duhur të problemeve në shumicën e rasteve, rindërtimi i shtëpive, marrja e masave për mos zhvendosjen e banorëve, funksionimi i ambulancës (sigurimi i derivateve) vizitat e mjekut në fshat, investimet dhe mbështetja për rimëkëmbjen e bujqësisë, aktivitetet kulturore për të rinjtë, si dhe mungesa e takimeve me drejtuesit lokalë ishin disa nga çështjet që banorët i shprehën si shqetësimet e tyre.¹³

Në takimet me përfaqësues të fshatrave Bistricë, Cerajë dhe Koshtovë e Vllahisë të komunës së Leposaviqit. zyrtarët komunal nga zyra për komunitete dhe kthim e Komunës së Leposaviqit dhe aktivistë tjerë nuk u paraqitën në tryezë.

Në këtë takim me banorët dhe përfaqësuesit e fshatrave Bistricë, Cerajë dhe Koshtovë e Vllahisë diskutuam për nevojat dhe shqetësimet që banorët hasin në përditëshmëri, në zonën më të thellë të rajonit të Shalës.

Pjesëmarrësit gjatë diskutimit adresuan shqetësime dhe kërkesa direkte, të cilat duhet të dërgohen në institucione përkatëse. Disa nga temat e ngritura ishin:










- Siguria dhe lirija e lëvizjes për banorët e këtyre fshatërave;
- Si pasojë e mungësës së një linje të transportit publik, shumë vajza dhe djem detyrohen që ta lënë shkollën e mesme, pasi që nuk kanë mundësi banimi në qytetin e Mitrovicës;
- Infrastruktura rrugore edhe 21 vite pas luftës, asnjë institucion lokal apo qendror nuk ka zhvilluar projekte për rregullimin e rrugës, për këta banorë;

- Mungesa e ambulancës / shtëpisë së shëndetit në fshatin Bistricë;
- Mos përfaqësimi dhe mos organizimi i komunitetit në këto fshatra, për këtë është kërkuar asistencë nga organizata REC që të ju ndihmojmë në organizimin e një takimi ku banorët do të zgjidhnin përfaqësuesit e fshatrave;
- Inicimi i takimeve me zyrtarë komunal, me Kryetarin e saj të sapozgjedhur dhe me nënkryetarin për komunitete që të adresohen nevojat e banorëve me kërkesa konkrete, po ashtu edhe me ndonjë Ministër në nivel qendror;
- Mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive për të rinjtë, edhe pse qendra është në shkollën e Bistricës, nuk ka aktivitete për të rinjtë;
- Dëmtimi që ju është bërë lumit Bistrica, nga ndëtimi i mini hidrocentralit, mos reagimi i institucioneve edhe pse ka pas aknesa dhe peticion nga banorët.

REC është zotuar që të lehtësoj procesin e përzgjedhjes së përfaqësuesit të këtyre fshatrave, ku si një trup kordinues do të inicohen takime për t'i adresuar nevojat dhe kërkesat e tyre, ndërsa REC zotohet në mbështetjen teknike të takimeve dhe në ofrimin e ndihmës rreth përpilimit të kërkesave/ankesave drejtuar institucioneve përgjegjëse.

¹³ Takim i dialogut publik me përfaqësues të fshatrave, gra dhe të rinjtë, 24 nëntor 2021

Gjetjet kryesore nga takimi me qytetarë

-  Infrastruktura rrugore shumë e dobët;
-  Mungesa e transportit publik;
-  Studentët në qytet nuk kanë transport të rregullt;
-  Banorët e kësaj pjese janë shpërngulur shumë;
-  Ka shumë shtëpi të pandërtuara që nga paslufta në Kosovë, të cilat nuk janë paraparë të ndërtohen as nga komuna, e as nga qeveria;
-  Ambulanca nuk funksionon siç duhet, dhe mjeku bën vizita shumë të rralla;
-  Nuk ka asnjë investim në bujqësi;
-  Nuk ka aktivitete kulturore dhe sportive për të rinjtë;
-  Mungojnë takimet me drejtuesit lokal.

Profili i shkurtër i komunës së Skënderaj dhe fshatrave të synuara

Komuna e Skënderajit, shtrihet në veri të Kosovës dhe është afër komunës së Mitrovicës, prandaj marrë parasysh aspektin politik dhe social është trajtuar edhe në kuadër të projektit si komunë me rëndësi të veçantë, konsideruar edhe përbërjen etnike të komunës.

Komuna e Skënderajit ka gjithsej 27 institucione arsimore parashkollore, fillore dhe të mesme, 55 me 678 arsimtarë, 56 me raportin 1.3 shkolla për 1000 banorë të

moshës deri në 19 vjeç. Në komunën e Skënderajit ekzistojnë 16 klube sportive aktive, dy teatro, tre biblioteka dhe tetë klube dhe shoqata artistike.¹⁴

Nevojat specifike të komuniteteve të identifikuara përmes takimeve të dialogut në komunitet:

Gjendja e përgjithshme e infrastrukturës në komunë vlerësohet si e mirë. Përafërsisht 92% e rrugëve që lidhin fshatrat me qendrën urbane janë të asfaltuara. Qyteti i Skënderajit dhe shtatë (7) nga 48 fshatra janë të kyçura në ujësjellës. Furnizimi me energji elektrike dhe kanalizimet janë ende problem, sidomos në fshatra.¹⁵

Në takimet e dialogut me komunitetet e targetuara, qytetarët dhe panelistët e pranishëm si: znj. Dorarta Ndreshaj, asambleiste e kuvendit komunal në Skënderaj nga radhët e AKR-së, znj. Vjollca Ramadani, asambleiste e kuvendit komunal në Skënderaj nga radhët e VV-së, si dhe zyrtarë komunal, kanë diskutuar temat e të drejtave të komunitetit, nevojave dhe shqetësimeve të adresuara në komunën e Skënderajit.

Pjesëmarrësit gjatë diskutimit adresuan shqetësime dhe kërkesa direkte karshi zyrtarëve komunal. Disa nga temat e ngritura ishin:

¹⁴ Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Skenderaj, <https://drejtoriaperkulturerini-sport.weebly.com/>

¹⁵ OSBE, Raport mbi profilin e Komunës së Skënderajit, https://www.osce.org/files/documents/8/9/13273_0.pdf

- Siguria dhe lirija e shprehjes, me theks të veçantë lirija e shprehjes në institucione komunale si dhe ofendimet që vijnë nga zyrtarët gjatë diskutimeve publike në kuvendin komunal, si dhe në komisione të ndryshme. Si rrjedhojë e këtij diskursi ofendues karshi gjinisë femërore, po sjell pasoja të mosan-gazhimit në jetën politike, dhe aktivizmi nga gratë dhe vajzat në këtë qytet;
- Mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive në qytet;
- Nepotizmi dhe diskriminimi në baza partiake;
- Papastërtia dhe deponitë ilegale të mbeturinave;
- Funksionalizimi i ambulancave/shtëpive të shëndetit në fshatrat më të thella.

Kandidatët për Kuvendin Komunal të Skenderajit dhe zyrtarët e komunës kanë

shprehur gadishmërinë që të bashkëpunojnë dhe të inicohen takime të ngajshme bashkëpunimi.

Gjetjet kryesore nga takimi me qytetarë

- Komuna të përfshijnë më shumë grupe të nënpërfaqësuar në hartimin e politikave lokale;
- Gjatë hartimit të buxhetit komunal, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet buxhetit të përgjegjshëm gjinor;
- Të forcohet roli i rinisë dhe organizatave rinore në komunitet;
- Partitë politike të përfshijnë më shumë gra në listat e tyre zgjedhore, nga bartësja e listës dhe kandidatja për kryetare komune;
- Organizatat e shoqërisë civile që punojnë për të drejtat e grave, të bëhen ura lidhëse midis grave në komunitet dhe autoriteteve lokale.



Rekomandimet

Sa i përket nevojave, pothuajse në çdo lokalitet, investimet në infrastrukturë zënë vendin parësor, duke qenë të nevojshme për përmirësimin e jetesës, si dhe rimëkëmbjen e ekonomisë. Infrastruktura jashtëzakonisht e shkatërruar është një nga arsyet kryesore që ndikon që banorët e këtyre anëve të shpërngulen. Kushtet e vështira ekonomike vetëm sa e vështirësojnë situatën e këtyre qytetarëve. Prandaj, investimet në bujqësi, dhe punësimi, veçanërisht i të rinjve, janë parakusht për të ndaluar këtë ndryshim/ulje demografike. Komunitet të përfshijnë më shumë grupe në hartimin e politikave lokale;

- Komunitet gjatë hartimit të buxhetit komunal, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet buxhetimit gjinor;
- Të forcohet roli i të rinjve dhe organizatave rinore në komunitet në të gjitha komunitet;
- Partitë politike të përfshijnë më shumë gra në listat e tyre zgjedhore, nga bartësja e listës dhe kandidatja për kryetare komune;
- Organizatat e shoqërisë civile që punojnë për të drejtat e grave, të bëhen ura lidhëse midis grave në komunitet dhe autoriteteve lokale;
- Komunitet duhet të organizojë dhe përditësojë rregullisht kanale për komunikim me qytetarët. Kjo mund të bëhet përmes faqeve në rrejtet sociale si Facebook, ueb faqe e interneti ose përdorimi i mediave lokale për promovim;

- Komunitet e Mitrovicës së Veriut dhe Mitrovicës së Jugut duhet të bashkëpunojnë më shumë në çështjen e të rinjve;
- Komunitet e Mitrovicës së Veriut dhe Leposaviqit duhet të bëjë përpjekje shtesë për sqarimin e Kornizës Ligjore të Kosovës për qytetarët në mënyrë që ata të ushtrojnë të drejtat e tyre;
- Komunitet e Leposaviqit të bëjë mbështetjen e komuniteteve me transport të rregullt, dhe veçanërisht vazhata të reja që ndjekin shkollën;
- Komunitet e Skënderajit të ketë më shumë bashkëpunim me përfaqësuesit lokal për adresimin e nevojave të komunitetit;
- Ndërmarrja e masave ndëshkuese për zyrtarët komunal të cilët nuk ofrojnë qasje në shërbime, të gjitha komunitet;
- Promovimi i legjisllacionit aktual për transparencën, të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve veçanërisht të grave dhe të rinjve duhet të jetë synim i të gjitha komuniteteve të targetuara;

Komunitet duhet të ndajnë më shumë informata për kornizat ligjore të Kosovës pasi qytetarët e komunitetit Serb në Veri nuk janë të njohur fare me ligjet dhe rregulloret. Komunitet duhet të diskutojë rregullisht për ato me qytetarët dhe duhet të ofrojë hapësirë për diskutime mbi procedurat.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ky raport është mundësuar me mbështetjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është në përgjegjësi të vetme të REC - Reconciliation Empowering Communities dhe nuk paraqet medoemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së SHBA-së.



www.rec-kosova.org

